



**ANALIZA E PARË GJASHTËMUJORE E RASTEVE TË
INDEKSIT TË INTEGRITETIT POLITIK
-Rrëfime individuale-**

Shkup, Qershor 2026

Përmbledhje ekzekutive

Kjo analizë gjashtë mujore e Indeksit të Integritetit Politik (IIP)¹ ofron një vlerësim të strukturuar të lidhjes midis sjelljes së mbajtësve të funksioneve publike dhe besimit të qytetarëve në institucione. Nëpërmjet analizës së rasteve të rëndësishme për media, vërehet dominim i shembujve negativë mbi ato pozitivë. Edhe pse këto raste nuk përbëjnë një përfaqësim statistik të tërë sistemit, ato tregojnë një trend më të gjerë ku zyrtarët publikë më shpesh gjenerojnë dyshim sesa besim.

Gjetja kryesore është se shkeljet e integritetit rrallë burojnë vetëm nga shkelje direkte të ligjit. Përkundrazi, në shumicën e rasteve bëhet fjalë për neglizhencë të dimensionit etik të funksionit, që krijon perceptim të konfliktit të mundshëm të interesit, selektivitetit ose mungesës së llogaridhënies. Pikërisht këto perceptime ndikojnë fuqishëm në besimin e qytetarëve, i cili ndërtohet jo vetëm përmes ligjshmërisë, por edhe përmes sjelljes së dukshme dhe të përgjegjshme të institucioneve.

Rasti me U.D., kryetaren e Gjykatës Penale Dimovska, ilustron se si konteksti institucional, deklaratat publike dhe lidhjet me një hetim që përfshin një anëtar të afërt të familjes krijojnë dyshim për ndikim në drejtësi. Në kushtet kur [besimi në drejtësi është jashtëzakonisht i ulët \(9%\)](#), situata të tilla thellojnë më tej perceptimin e mungesës së paanshmërisë.

E njëjta logjikë vërehet edhe në rastin e liderit sindikal Ralpovski, ku koicidenca kohore mes aktivitetit sindikal dhe emërimit të tij në një institucion shtetëror ngre pyetje për autonominë e veprimit sindikal. Edhe pse nuk ka prova formale të paligjshmërisë, mundësia e kooptimit ul besimin në pavarësinë e sindikatave.

Rasti i përfaqësuesit sindikal në M-NAV, Aleksandar Tasevski, ilustron në mënyrë të qartë dinamikën e besimit publik. Pozicioni i tij fillestar, i ndërtuar mbi mbrojtjen e interesit publik, krijoi një nivel të lartë kredibiliteti. Megjithatë, akuzat për keqpërdorim të pozitës për përfitime personale çuan në një rënie të menjëhershme dhe të thellë të integritetit. Ky rast dëshmon se besimi nuk është një kategori statike, por një proces i vazhdueshëm që ndërtohet dhe shumë lehtë mund të rrënohet.

Në rastin e zëvendëskryeministrit Fetai, problemi është më struktural dhe më i rëndë, sepse lidhet me mungesën në ushtrimin e funksionit, marrjen e pagës dhe mungesën e reagimit institucional.

Vlen të theksohet se, që nga përgatitja e kësaj analize, nën presion publik, zëvendëskryeministri Fetai dha dorëheqje më 1 qershor 2026. Dorëheqja e tij u pranua nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhjetë ditë më vonë dhe më 11 qershor u formalizua shkarkimi i tij. Megjithatë, ky zhvillim nuk e zhbën faktin se për një periudhë prej dy muajsh, zëvendëskryeministri për mirëqeverisje nuk është paraqitur në vendin e punës, nuk ka qenë në vend dhe nuk ka treguar transparencë apo llogaridhënie për mungesën dhe mosveprimin e tij. Në thelb, sjellja e tij përbën shkelje të Kodit Etik që vetë ishte i obliguar ta respektonte. Përmasë shtesë i jep fakti se bëhet fjalë për funksion përgjegjës për mirëqeverisjen, çka përforcon perceptimin e një papërpunueshmërie sistematike dhe minon idenë e llogaridhënies.

¹ <https://shorturl.at/KO8xS>

Në kontrast me këto raste, shembulli i Lençe Ristoska është një model pozitiv i integritetit. Dorëheqja e saj, e arsyetuar me pamundësi për të vepruar sipas parimeve profesionale, tregon përputhshmërinë midis vlerave dhe veprimeve. Ky rast demonstroi se integriteti konfirmohet përmes vendimeve konkrete, veçanërisht kur ato sjellin kosto personale ose profesionale, dhe për këtë arsye vlerësohet si “ndërtues norme”.

Gjithashtu, largimi i deputetit Mile Cekov nga grupi parlamentar, shoqëruar me komunikim publik të qartë dhe transparent në aspektin politik, paraqet një kontrast me zëvendëskryeministrin Fetaj. Në rastin e deputetit Cekov, integriteti politik është baza e hapit të ndërmarrë që nënkupton distancim nga partia politike që vepron në kundërshtim me premtimet parazgjedhore dhe me orientimet e tij ideologjike dhe politike. Ky hap, jashtëzakonisht i rrallë në shtëpinë ligjvënëse, vlerësohet gjithashtu si “ndërtues norme”.

Analiza eidenton më tej dobësi në reagimet institucionale. Veprimet ndërmerren kryesisht nën presion mediatik dhe publik, ndërsa mekanizmat parandalues mbeten të pazhvilluar ose pothuajse inekzistentë. Kjo krijon një cikël në të cilin dyshimet grumbullohen dhe besimi publik gërryhet gradualisht. Ndërkohë, debati publik shpesh kufizohet në raportimin fillestar, pa një ndjekje të qëndrueshme të zhvillimeve, gjë që e pengon transparencën dhe e vështirëson “këndvështrimin” dhe kuptimin e plotë të situatës nga ana e qytetarëve.

Në një kontekst më të gjerë, kjo dinamikë mund të krahasohet me përvojat rajonale. Për shembull, procesi i reformave të drejtësisë në Maqedoninë e Veriut pas krizës politike 2015–2017 tregoi se mungesa e integritetit në institucione mund të çojë në një krizë të thellë politike dhe shoqërore. Nga ana tjetër, raste individuale të marrjes së përgjegjësisë, si dorëheqja e Ivo Sanaderit dhe procedurat gjyqësore që vijuan në Kroaci, treguan se reagimi institucional mund të kontribuojë në rikthimin e besimit, megjithëse për këtë, përveç përgjegjësisë, nevojitet edhe një distancë kohore e konsiderueshme.

Përfundimi kryesor është se besimi në institucione nuk varet vetëm nga ekzistenca formale e tyre, por nga veprimet konkrete dhe sjellja e funksionarëve që i përfaqësojnë. Rastet negative të përfshira në analizë tregojnë dobësi në përgjegjësi, llogaridhënie dhe sjellje etike, ndërsa shembulli pozitiv tregon se integriteti është i mundur edhe në rrethana institucionale komplekse. Prandaj, forcimi i besimit kërkon përfundim të integritetit personal të mbajtësve të funksioneve dhe krijimin e mekanizmave institucionale që do ta mbështesin dhe shpërblejnë sjelljen e tillë.

Rrjedhimisht, rikthimi i besimit kërkon një qasje të dyfishtë: forcimin e integritetit individual dhe ndërtimin e mekanizmave institucionale efektive që e mbështesin dhe e nxisin atë. Erozioni i besimit në institucione nuk është as i rastit dhe as i pashmangshëm, por rezultat i veprimeve, vendimeve dhe dështimeve konkrete. Po kështu, besimi mund të rikthehet, por vetëm nëse integriteti shndërrohet në standard dhe jo në përjashtim në funksionimin e institucioneve.

I - Hyrje

Indeksi i Integritetit Politik (IIP) është një mjet që analizon lidhjen midis sjelljes së mbajtësve të funksioneve publike, reagimeve institucionale dhe besimit të qytetarëve në institucione.

Vlera e tij qëndron në aftësinë për ta shndërruar idenë abstrakte të integritetit në një koncept të matshëm përmes kategorive si sundimi i ligjit, kultura etike, korrupsioni, transparencia, mbrojtja e interesit publik dhe të tjera. Kjo analizë e gjashtë rasteve të trajtuara secila veç e veç, të cilat kanë qenë të pranishme në eterin mediatik gjatë disa muajve të fundit, tregon një disbalancë të qartë: katër raste me vlerësim negativ dhe dy me vlerësim pozitiv. Duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për tema që kanë dominuar në eter dhe për të cilat ekzistojnë raporte mediatike, prandaj përqindja është vetëm një tregues i një trendi më të gjerë ku sjellja individuale gjithnjë e më shumë e dobëson besimin në institucione.

Modeli i përgjegjësisë së komprometuar

Kur rastet analizohen në mënyrë individuale, vërehet se problemi rrallë kufizohet vetëm në shkelje të drejtpërdrejta ligjore, por më shpesh lidhet me braktisjen e dimensionit etik të funksionit dhe krijimin e hapësirës për dyshime mbi shkelje të mundshme të kodeve dhe ligjeve. Në rastin e U.D., kryetares së Gjykatës Penale, Dimovska, kombinimi i momentit të zgjedhjes, deklaratave publike dhe lidhjes me një hetim ku përfshihet një anëtar i afërt i familjes krijon perceptimin e mundësisë së ndikimit në drejtësi. Në situata të tilla, perceptimi bëhet pothuajse po aq i rëndësishëm sa edhe faktet, pasi besimi varet nga bindja e qytetarëve se sistemi është i paanshëm. Duke marrë parasysh [të dhënat](#) që tregojnë se vetëm rreth 9% e qytetarëve kanë besim në sistemin gjyqësor, është e arsyeshme të pritët që raste të tilla jo vetëm që nuk e forcojnë besimin, por përkundrazi kontribuojnë në thellimin e mëtejshëm të mosbesimit.

E njëjta dinamikë vërehet edhe në rastin e liderit sindikal Ralovski. Koincidenca kohore mes aktivitetit të tij sindikal dhe emërimit në një institucion shtetëror ngre pikëpyetje mbi autonominë e veprimit sindikal. Edhe në mungesë të provave formale për parregullsi, krijohet perceptimi i mundësisë së kooptimit, çka dëmton besimin në pavarësinë e sindikatave, të cilat sipas [hulumtimeve](#) tashmë renditen në nivele të ulëta besimi.

Rasti i përfaqësuesit sindikal në M-NAV, Tasevski, qartë ilustron dinamikën e besimit. Pozicioni fillestar i mbrojtjes së interesit publik krijon një shkallë të lartë besimi, por pretendimet për keqpërdorim të pozitës për qëllime personale çojnë në një rënie të shpejtë dhe të thellë. Kjo tregon se integriteti nuk është statik, por konfirmohet ose humbet përmes sjelljes së vazhdueshme.

Rasti i zëvendëskryeministrit Fetaj është shembulli më i elokuent i përgjegjësisë së cenuar individuale për shkak të mungesës në ushtrimin e funksionit që duhet të mbrojë integritetin e të tjerëve. Mungesa në punë dhe mungesa e reagimit institucional krijojnë përshtypjen e një sistemi që nuk ndëshkon dështimet e dukshme. Kjo minon idenë e llogaridhënies si parim themelor të qeverisjes së të gjithë funksionarët, por në këtë rast është më e rëndë, sepse vetë zëvendëskryeministri Fetaj është përgjegjës për mirëqeverisjen. Mandati i Fetait përfshin sigurimin e mirëqeverisjes së të gjithë funksionarëve publikë; kur ai vetë nuk e respekton këtë mandat, përgjegjësia dhe pesha e mungesës së integritetit janë edhe më të

mëdha. Kur pikërisht garantuesi i integritetit shfaq mungesë të tij personale në këtë aspekt, besimi i qytetarëve në institucion cenohet seriozisht.

Përfundimi dhe integriteti si vendim i vetëdijshëm

Në kontrast me këto raste, shembulli i prokurores Lençe Ristoska si dhe shembulli i deputetit Mile Cekov paraqesin një model të qartë pozitiv. Vendimi për të dhënë dorëheqje për shkak të pamundësisë për të vepruar sipas parimeve profesionale ose orientimeve politike-ideologjike tregon përputhshmërinë midis vlerave dhe veprimeve.

Këto raste janë domethënëse sepse tregojnë se integriteti nuk është thjesht deklarativ, por dëshmohet përmes vendimeve konkrete, veçanërisht kur ato shoqërohen me kosto personale ose profesionale. Në një mjedis ku ruajtja e pozicionit shpesh shihet si prioritet, veprime të tilla shërbejnë si shembuj për vendosjen e standardeve. Këto veprime nuk i dobësojnë pozicionet e tyre në sytë e qytetarëve; përkundrazi, i përforcojnë ato, pasi dëshmojnë se sistemi ka kapacitet për vetëkorrigjim. Pikërisht për këtë arsye, raste të tilla mund të konsiderohen “ndërtues norme”. Edhe pse burojnë nga probleme sistemike, ato tregojnë se individit mund të veprojë në përputhje me parimet profesionale dhe, në këtë mënyrë, të vendosë standarde pozitive të sjelljes.

Integriteti si sinjal për sistemin

Kur të gjitha rastet shqyrtohen së bashku, del në pah një pikturë e qartë e një sistemi që reagon në mënyrë të kushtëzuar (kryesisht nën presion mediatik dhe publik), por që rrallë arrin të veprojë në mënyrë parandaluese. Institucionet shpesh reagojnë me vonesë, në mënyrë selektive ose të papërshtatshme, ndërsa individët rrallë marrin iniciativë për të mbajtur përgjegjësi dhe për të vendosur standarde etike, duke e lënë pas dore besimin e qytetarëve.

Kjo krijon një cikël ku dyshimet grumbullohen dhe besimi bie gradualisht. Perceptimi i qytetarëve nuk formohet vetëm nga rezultatet ligjore, por edhe nga sjellja e dukshme e aktorëve institucionalë. Kur kjo sjellje është e paqëndrueshme dhe joetike, besimi dëmtohet, edhe në mungesë të vendimeve përfundimtare gjyqësore.

Debat publik minimal pa ndjekje të rezultateve

Si një dimension i veçantë spikat roli i hapësirës publike dhe mënyra se si trajtohen ngjarjet. Mediat raportojnë për zhvillimet dhe, falë tyre, qytetarët informohen dhe mundësohen analiza të tilla. Megjithatë, në debatin publik shpesh mungon një trajtim më i thelluar, veçanërisht në lidhjen e këtyre ngjarjeve me pasojat e tyre afatgjata dhe raportet shkak-pasojë.

Po ashtu, rrallëherë ndiqen zhvillimet e mëtejshme apo rezultatet përfundimtare të rasteve, çka çon në diskutime të pjesshme dhe pak të informuara, të mbështetura kryesisht në raportimin fillestar. Si pasojë, përfundimet mbi të cilat qytetarët ndërtojnë ose humbin besimin në institucione formohen kryesisht nga informacioni i momentit, pa një analizë të thelluar dhe pa ndjekje të mëvonshme që mund të ndryshojë ose nuancojë këto përfundime

II - Raste individuale

II.1 Rasti – U.D. Kryetare e Gjykatës Themelore Penale – Shkup, Daniela Dimovska



Në fokus të kësaj analize është ushtruesja e detyrës së kryetares së Gjykatës Themelore Penale – Shkup, Daniela Dimovska, zgjedhja e saj si ushtruese detyre e kryetares dhe lidhja e saj me rastin e zjarrit në diskotekën “Puls” në Koçan.

Zjarri në diskotekën “Puls” në Koçan është tragjedia më e rëndë me të cilën është përballur shteti që nga pavarësia e tij. Jetën e humbën tragjikisht dhe brutalisht 63 të rinj, që për një qytet me madhësinë e Koçanit përfaqëson pothuajse një gjeneratë të tërë të re. Është e padiskutueshme që shkaqet e kësaj tragjedie qëndrojnë në një [sistem jofunksional](#) që nuk është i ndërtuar për të garantuar standardet

minimale të sigurisë dhe respektimin e normave ligjore për mbrojtjen e qytetarëve.

Kryeministri Hristijan Mickoski, që në [konferencën](#) e parë për shtyp, mbrëmjen pas tragjedisë në Koçan, deklaroi se ekzistojnë elemente korrupsioni dhe manipulimi të sistemit. Më vonë, si përmes [gazetarisë hulumtuese](#), ashtu edhe përmes deklaratave të [Prokurorisë Themelore Publike](#), në opinion u shfaqën informacione që konfirmojnë se korrupsioni ka mbijetuar të gjitha garniturat politike gjatë një periudhe prej 13 vitesh, aq sa ekziston diskoteka.

Në këto rrethana, veprimi i drejtë dhe jodiskriminues i organeve hetimore dhe gjyqësore është e vetmja mundësi për rikthimin e besimit të qytetarëve në sistem. Prandaj, është e domosdoshme të shqyrtohet ekzistenca e një konflikti të mundshëm interesi, dyshime për ndikime të mundshme dhe selektivitet, përkatësisht nëse dhe në çfarë mënyre pozita e u.d. kryetares Dimovska mund të ndikojë në procesin gjyqësor në të cilin është i dyshuar vëllai i saj.

Vlerësimi i integritetit politik: kategoria NJOLLË me vlerë negative –6

Ekzistojnë indikacione dhe dyshime publike për sjellje joetike, por nuk ka reagim institucional dhe nuk ka presion publik apo fokus mediatik mbi këtë aspekt të rastit “Puls”. Sipas [indikatoreve](#) të metodologjisë së indeksit, vlerësimi për integritetin politik është -6.

Kategori: Kultura etike

Argument kyç:

1. Vëllai i u.d. kryetares së Gjykatës Themelore Penale – Shkup më vonë është i dyshuar për korrupsion lidhur me pronarin e diskotekës “Puls”.

Hetimi i Prokurorisë Themelore Publike për rastin e zjarrit në diskotekën “Puls” fillimisht nuk i përfshiu inspektorët e Drejtorisë së të Ardhurave Publike. Ndërkohë, në publik u shfaq një storie gazetareske ku u publikua komunikimi ndërmjet pronarit të diskotekës “Puls” dhe inspektorëve të DAP-it. Me gjasë si rezultat i kësaj [storie hulumtuese](#) që nxori në dritë prova për korrupsion, përkatësisht marrje/dhënie ryshfeti, u hap një hetim i ri në të cilin përfshihet edhe inspektori Dragan Paunov, vëllai i u.d. kryetares së Gjykatës Themelore Penale Shkup, Daniela Dimovska. Edhe pse ky rast nuk është lidhet me rastin aktual për zjarrin në diskotekën “Puls”, pasi nuk ka lidhje me pasojën e dëmshme, vetë [dyshimi për korrupsion](#) i lidhur me funksionimin e diskotekës “Puls” dhe kërkesa e Prokurorisë për paraburgim efektiv për Dragan Paunov përbëjnë indikator të përfshirjes së tij në veprimtari të paligjshme.

Dyshime shtesë për ndikim të paligjshëm dhe joetik ngre fakti se kërkesa për paraburgim efektiv është refuzuar; Paunovit i është caktuar paraburgim shtëpiak, i cili më pas është hequr dhe aktualisht ndaj tij janë vendosur masa sigurie me mundësi për t’u mbrojtur në liri. Mbrojtja e Paunovit dhe u.d. kryetarja e Gjykatës Penale Shkup, Daniela Dimovska, kanë mohuar çdo [ndikim të mundshëm në vendimin e gjykatës](#).

Rekomandim për mbrojtjen e integritetit:

Tërheqja nga funksioni e u.d. kryetares së Gjykatës Themelore Penale Shkup me qëllim sigurimin e besimit në procesin gjyqësor për rastin e zjarrit në diskotekën “Puls”.

Nëse ushtruesja e detyrës së kryetares, Daniela Dimovska, ka qenë apo jo në dijeni për përfshirjen e vëllait të saj në aktivitetet e mëparshme të diskotekës, mbetet një çështje dytësore. Megjithatë, fakti që ajo nuk është tërhequr nga funksioni pas hapjes së një hetimi të ri, në të cilin vëllai i saj është i dyshuar, ngre pikëpyetje serioze mbi integritetin e saj.

Pozita e saj krijon mundësi për ndikim në procesin gjyqësor, si ndaj gjyqtarëve që i janë vartës, ashtu edhe ndaj atyre të procedurës paraprake që vendosin për masat e paraburgimit në Gjykatën Themelore në Koçan dhe Gjykatën e Apelit në Shtip. Njëkohësisht, ekziston edhe mundësia e ndikimit në opinionin publik përmes deklaratave të saj. Të gjitha këto, së bashku me konfliktin e mundshëm të interesit, ndikojnë drejtpërdrejt në besimin që qytetarët duhet të kenë në sistemin e drejtësisë dhe në sigurimin e një procesi gjyqësor të drejtë. Një funksionar me integritet, i vendosur për të mbrojtur interesin publik dhe drejtësinë, do të tërhiqej menjëherë për të garantuar besimin e qytetarëve në procesin gjyqësor për këtë rast.

Rekomandime:

Duke qenë se emërimi dhe shkarkimi i ushtrueses së detyrës së kryetares së Gjykatës Themelore Penale në Shkup është në kompetencë të Këshillit Gjyqësor, rekomandohet që ky institucion të hapë një procedurë dhe të shqyrtojë këtë konflikt të mundshëm interesi, si dhe ndikimin e mundshëm në procesin në të cilin është i dyshuar edhe vëllai i saj. Nëse vlerësohet e nevojshme, Këshilli Gjyqësor mund të përditësojë aktet nënligjore që rregullojnë këtë çështje. Njëkohësisht, ai ka kompetencë të drejtpërdrejtë për të vendosur për tërheqjen ose shkarkimin e saj, në të njëjtën mënyrë siç është bërë edhe emërimi.

Në fund, një trajtim i tillë do të kontribuonte jo vetëm në forcimin e besimit të qytetarëve se Këshilli Gjyqësor mbron interesin publik dhe drejtësinë, por edhe në largimin e çdo dyshimi se emërimi i saj mund të krijojë hapësirë për shmangien e drejtësisë për personat e dyshuar dhe ata që po gjykohen në rastin e zjarrit në diskotekën “Puls” në Koçan.

II.2 Rasti - Lideri sindikal Blagoja Ralpovski, kryetar i Konfederatës së Sindikatave të Lira (KSL)



Në fokus të kësaj analize është përfaqësuesi sindikal Blagoja Ralpovski (kryetar i Konfederatës së Sindikatave të Lira – KSL), në kontekst të sjelljes së tij gjatë protestave për rritjen e pagës minimale dhe emërimit të tij të mëvonshëm si anëtar i Bordit Drejtues të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor (FSPIM).

Rasti merr vëmendje publike në një periudhë të intensifikimit të aktiviteteve sindikale dhe paralajmërimeve për bllokim të Qeverisë për shkak të pakënaqësisë me nivelin e pagës minimale. Pyetja kyçe nga këndvështrimi i integritetit politik është nëse krijohet një perceptim i konfliktit ndërmjet autonomisë sindikale dhe një kooptim institucional të mundshëm përmes emërimit në një organ drejtues të një institucioni shtetëror.

Vlerësimi i integritetit politik: kategoria NJOLLË me vlerë negative –6

Sipas Metodologjisë së Indeksit të Integritetit Politik, në këtë rast ekzistojnë indikacione të dokumentuara publikisht për një konflikt të mundshëm interesi, si dhe fokus mediatik dhe debat publik, por mungon një përgjigje formale institucionale, reagim apo procedurë ligjore.

Bëhet fjalë për kategorinë “Njollë” (–4 deri –6), ku vlerësimi –6 i korrespondon një situatë në të cilën ekzistojnë dyshime etike dhe perceptim për mospërputhje, por pa paligjshmëri të konfirmuar.

Në kuadër të Indeksit të Integritetit Politik, raste të tilla përfaqësojnë një “Njollë” – pra një sinjal paralajmërues për komprometim të mundshëm të integritetit, që kërkon shpjegim transparent dhe qartësi institucionale me qëllim ruajtjen e besimit të publikut.

Kategori: Ndikimi i elitave

Argumentet kryesore

1. Mospërputhje ndërmjet qëndrimit sindikal dhe emërimit institucional

Në një periudhë kur Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë (LSM) [paralajmëron dhe organizon protesta](#) dhe grevë të përgjithshme për pagën minimale, në media është evidentuar se Ralpovski [nuk ka marrë pjesë në protesta](#), ndërsa menjëherë pas kësaj është [emëruar si anëtar i ri në Bordin Drejtues të FSPIM](#).

Kjo krijon perceptimin e një kooptimi të mundshëm institucional. Përputhja kohore ndërmjet protestave dhe emërimit në një organ drejtues të një institucioni shtetëror hap çështje etike lidhur me autonominë e veprimit sindikal. Anëtarësimi në Bordin Drejtues të FSPIM përfaqëson një pozitë me interes publik, me ndikim mbi sistemin pensional.

Një lider sindikal që përfaqëson të drejtat e punëtorëve duhet të demonstrojë një distancë të qartë nga ndikimet e mundshme politike. Rasti zhvillohet në një periudhë të kërkesave të [shtuara sociale dhe paralajmërimeve për bllokada](#), gjë që e rrit më tej ndjeshmërinë e publikut ndaj kompromisave të mundshme ose marrëveshjeve joparimore ndërmjet sindikatave dhe pushtetit ekzekutiv.

Rekomandim për përgjegjësi individuale në funksion të mbrojtjes së integritetit:

Tërheqja e anëtarit të emëruar Ralpovski nga Bordi Drejtues i FSPIM, me qëllim mbrojtjen e integritetit dhe rikthimin e besimit të qytetarëve në organizatën sindikale që ai udhëheq.

II.3 Rasti - Përfaqësuesi sindikal i kontrollorëve të fluturimit në M-NAV Aleksandar Tasevski dhe dyshimet për keqpërdorim të pozitës sindikale



Në fokus të kësaj analize është përfaqësuesi sindikal i kontrollorëve të fluturimit në M-NAV, Aleksandar Tasevski, në kontekstin e një [kallëzimi penal për dyshim për keqpërdorim të detyrës dhe autorizimeve zyrtare](#). Sipas informacioneve të publikuara, kallëzimi lidhet me përdorimin e ditëve të paguara për aktivitete sindikale, ku ka pretendime se, në vend të një agjende zyrtare, është realizuar një vizitë private në Qipro. Rasti merr peshë të shtuar publike për shkak të faktit se Tasevski për një periudhë të gjatë në [publik është paraqitur si një nga kritikët më të zëshëm të gjendjes në M-NAV](#), veçanërisht sa i përket sigurisë së trafikut ajror, ndikimeve politike dhe [funksionimit institucional](#). Në hapësirën publike ai është perceptuar si një [person që sinjalizon parregullsi dhe vepron](#) në drejtim të mbrojtjes së interesit publik, çka ka kontribuar në një nivel të lartë besimi në [integritetin e tij personal dhe profesional](#). Pikërisht për këtë arsye, pretendimet se pozita sindikale mund të jetë përdorur për qëllime private ngrenë

pyetje serioze për llogaridhënien, integritetin dhe përgjegjësinë e bartësve të besimit publik dhe profesional.

Vlerësimi i integritetit politik

Kategoria: Kulturë etike dhe mbrojtje e interesit publik

Vlerësimi: Njollë (-4)

Kronologjia e ngjarjeve

Gjatë vitit 2025 dhe në fillim të vitit 2026, sindikata e kontrollorëve të fluturimit e udhëhequr nga Tasevski alarmoi publikisht për gjendjen në M-NAV, përfshirë pretendime për [pajisje të vjetruara dhe rreziqe për sigurinë](#), si edhe për [ndikime politike në punësime](#). Më pas pasuan [njoftime për grevë](#) dhe kërkesa për [anulimin e konkurseve për punësim](#), pas së cilave drejtuesit reaguan me pretendime se [siguria nuk ishte e rrezikuar](#) dhe se po qarkullonin informacione të pasakta. Konflikti u përshkallëzua me [procedurë gjyqësore](#), ku [greva u shpall e paligjshme](#), ndërsa drejtuesit paralajmëruan [kallëzime penale](#). Paralelisht, në publik u shfaqën kritika edhe për një pjesë të [retorikës](#) së përdorur në paraqitjet publike lidhur me [“mbylljen e hapësirës ajrore”](#). Pika kyçe e kthesës në rast është kallëzimi penal ndaj Tasevskit për dyshim për keqpërdorim të detyrës dhe autorizimeve zyrtare. Sipas të dhënave publike, ekzistojnë dyshime se ai ka përdorur ditë të paguara të miratuara për aktivitete dhe takime sindikale, ndërsa në vend të një agjende zyrtare ka realizuar një udhëtim privat në Qipro. Rasti ngre pyetje për llogaridhënien dhe integritetin e bartësve të funksioneve sindikale, sidomos kur bëhet fjalë për përdorimin e autorizimeve dhe të drejtave të besuara që burojnë nga pozita sindikale.

Argumentet kryesore

1. **Pretendime për përdorim të përfitimeve zyrtare për qëllime private.** Sipas informacionit publik, ka dyshime se ditët e paguara të miratuara për aktivitete sindikale janë përdorur për udhëtim privat, në vend të agjendës zyrtare.
2. **Keqpërdorim i mundshëm i pozitës së besuar.** Rasti ngre pyetje për kufijtë e përdorimit të autorizimeve sindikale dhe përgjegjësinë e përfaqësuesve që disponojnë me besim dhe të drejta institucionale.
3. **Besimi publik dhe rreziku më i lartë për integritetin.** Tasevski në publik është njohur si përfaqësues sindikal që sinjalizon dobësi institucionale dhe rreziqe të mundshme në funksionimin e M-NAV, prandaj pretendimet për keqpërdorim të mundshëm të pozitës sindikale kanë peshë të shtuar dhe ndikojnë drejtpërdrejt në besimin ndaj përfaqësimit sindikal.
4. **Dëmtim i integritetit të përfaqësimit sindikal.** Kur ka dyshime se një pozitë sindikale është përdorur për qëllime personale, kjo mund të ndikojë në besimin ndaj organizatës dhe në kredibilitetin e veprimit sindikal në publik.

Rekomandim për mbrojtjen e integritetit

Rasti i Aleksandar Tasevskit përbën një shembull kompleks ku përplasen veprimi sindikal, interesit publik dhe përgjegjësia institucionale. Edhe pse paraqitjet dhe veprimtaria e tij fillestare publike u

perceptuan si përpjekje për të sinjalizuar gjendjen e interesit publik dhe për të mbrojtur sigurinë në M-NAV, pretendimet pasuese për keqpërdorim të mundshëm të pozitës sindikale hapin pyetje serioze për integritetin dhe llogaridhënien e bartësve të besimit publik.

Në kuadër të **Indeksit të Integritetit Politik**, rasti klasifikohet si “**Njollë**” për shkak të dyshimeve për përdorim të pozitës së besuar për qëllime private dhe për shkak të dëmtimit të mundshëm të besimit në përfaqësimin sindikal.

Në këtë drejtim:

- institucionet ta sqarojnë rastin në mënyrë transparente dhe t’i bëjnë publike faktet e konstatuara dhe rezultatin e procedurës;
- Sindikata e Kontrollorëve të Fluturimit të forcojë më tej mekanizmat e llogaridhënies së brendshme dhe standardet etike;
- të shqyrtohet përditësimi i Kodit Etik të sindikatës, veçanërisht në pjesën që lidhet me përdorimin e të drejtave sindikale, komunikimin publik dhe parandalimin e çdo keqpërdorimi të mundshëm të pozitës sindikale për qëllime personale.

III.4 Rasti – Zëvendëskryeministri për Qeverisje të Mirë - Arben Fetai



Rasti i referohet raportimeve mediatike dhe deklaratave publike sipas të cilave zëvendëskryeministri për qeverisje të mirë, Arben Fetai, për një periudhë të gjatë kohore nuk paraqitet në punë dhe nuk merr pjesë në seancat e Qeverisë, pavarësisht se zyrtarisht e ushtron funksionin dhe merr pagë. Ky rast ngre pyetje lidhur me përgjegjësinë në ushtrimin e detyrave zyrtare dhe respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë, veçanërisht për shkak se ky zëvendëskryeministër është i ngarkuar në mandatin e tij të zbatojë politika për qeverisje të mirë.

Kategori: Mbrojtja e interesit publik

Vlerësimi i integritetit politik: Skandal (-9)

Pretendimet e shumëfishta publike për mungesë nga puna dhe mosushtimin e detyrave themelore zyrtare, marrja e rregullt e pagës dhe mungesa e një reagimi të qartë institucional, tregojnë dyshime serioze mbi respektimin e parimeve të llogaridhënies dhe përgjegjësisë. Megjithëse nuk ka informacione për procedurë zyrtare juridike, me përjashtim [të deklaratës së kryeministrit Mickoski lidhur me një funksion të mundshëm të ardhshëm](#), serioziteti dhe vazhdimësia e pretendimeve në hapësirën publike nënvizojnë nevojën për veprim institucional. Sipas Ligjit për Qeverinë, funksionarët e ushtrojnë funksionin e tyre derisa Kuvendi të votojë zyrtarisht një mandat të ri për një person tjetër, dhe i njëjti të verifikohet.

Peshë shtesë ka fakti se bëhet fjalë për një funksionar resorti i të cilit është pikërisht qeverisja e mirë, gjë që e përforcon përgjegjësinë e pritshme dhe standardin e sjelljes. Sipas metodologjisë, kjo gjendje kualifikohet si “Skandal” me vlerën –9.

Argumentet kryesore

- **Pretendime për mungesë afatgjate nga vendi i punës**

Sipas deklaratave publike dhe raportimeve mediatike, zëvendëskryeministri Arben Fetai [nuk vjen në punë](#) në Qeveri për një periudhë të gjatë kohore dhe [nuk merr pjesë në seancat e Qeverisë](#), gjë që përbën një pjesë kyçe të detyrave të tij.

- **Marrja e pagës pa ushtimin e dukshëm të funksionit**

Në publik dalin informacione se pavarësisht mungesës, zëvendëskryeministri [vazhdon të marrë pagë](#).

- **Mungesa pa shpjegim zyrtar**

Në një pjesë të [deklaratave thuhet se zëvendëskryeministri nuk ndodhet në vend](#), pa asnjë shpjegim të qartë dhe zyrtar. Në kontekstin e mungesës, ekziston një postim i tij publik ku [ai ndodhet në Tailandë](#), por pa asnjë shpjegim zyrtar.

- **Mungesa e reagimit institucional**

Nuk vërehen masa ose procedura konkrete për përcaktimin e përgjegjësisë, gjë që tregon dobësi në mekanizmat e kontrollit dhe llogaridhënies. Për më tepër, ekziston [Kodi i Sjelljes Etike të anëtarëve të Qeverisë](#), zbatimi i të cilit është në [kompetencë të zëvendëskryeministrit për qeverisje të mirë](#). Në këtë kontekst, lind një situatë në të cilën mbajtësi i kësaj kompetence është vetë objekt i pretendimeve, gjë që e ndërlikon më tej nevojën për reagim institucional.

I. Rekomandime në drejtim të mbrojtjes së integritetit

- Zëvendëskryeministri për qeverisje të mirë të japë dorëheqje për arsye morale
- Qeveria të dalë publikisht lidhur me rastin, të sigurojë transparencë dhe të ndërmarrë masa konkrete për përcaktimin e përgjegjësisë

- Vendosje mekanizma të qartë për ndjekjen e prezencës dhe punës së mbajtësve të funksioneve publike
- Të ndërmerren masa institucionale të përshtatshme nëse konstatohen parregullsi

II. Rekomandime sipas dispozitave të Kodit të Sjelljes Etike për anëtarët e Qeverisë dhe mbajtësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria:

Raportimi i dyshimit për konflikt interesi (ekstrakt nga Kodi)

Neni 22

Me kërkesën e anëtarëve të Qeverisë, zëvendësministrave dhe funksionarëve të tjerë të emëruar nga Qeveria, me iniciativë të vetë personit ose pas marrjes së informacionit, personi për këshillim mbi zbatimin e Kodit do t'i këshillojë ata për çdo çështje sjelljeje dhe çështje etike të lidhura me këtë kod dhe do të japë rekomandime të përgjithshme për veprim të mëtejshëm. Mbajtësit e funksioneve ekzekutive bashkëpunojnë me anëtarin e Qeverisë përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Kodit dhe i vënë në dispozicion të gjitha informacionet relevante që ai do t'i kërkojë, me përjashtim të atyre që kanë karakter të informacioneve të klasifikuara. Mbajtësit e funksioneve ekzekutive, menjëherë, dhe jo më vonë se tre ditë nga dita e kryerjes ose njohjes së mospërdorimit të dispozitave të këtij kodi, e informojnë kryetarin e Qeverisë dhe anëtarin e Qeverisë përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Kodit, në rast të ekzistencës së dyshimit që ka të bëjë me zbatimin e këtij kodi gjatë ushtrimit të funksionit ose detyrës.

Rekomandim sipas nenit 22: reagim i menjëhershëm dhe aktivizim i mekanizmave institucionalë në situatat që mund të cenojnë integritetin e funksionit dhe institucionit.

Rekomandim sipas nenit 22: anëtarët e Qeverisë të veprojnë në përputhje me këto dispozita, respektivisht të raportojnë rastin dhe të aktivizohen procedurat e parashikuara me qëllim zbatimin konsistent të Kodit.

Masat në rast të mosrespektimit të Kodit (ekstrakt nga Kodi)

Neni 23

Në rast të mosrespektimit të dispozitave të këtij kodi, anëtari i Qeverisë përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Kodit, i dërgon vërejtje me shkrim mbajtësit të funksionit ekzekutiv se ka shkelur Kodin dhe i tregon që brenda tre ditëve nga dorëzimi i vërejtjes ta korrigjojë sjelljen.

Nëse mbajtësi i funksionit ekzekutiv brenda afatit të paragrafit 1 të këtij neni nuk e korrigjon sjelljen,

anëtari i Qeverisë përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Kodit i dërgon mendim kryetarit të Qeverisë, mbi bazën e të cilit kryetari i Qeverisë mund të vendosë të zbatojë njërin nga masat e mëposhtme:

- kritikë zyrtare publike ndaj sjelljes së personit që nuk e ka respektuar këtë kod dhe kërkesë për korrigjimin e sjelljes, ku e njëjta mund të publikohet edhe në faqen e internetit të Qeverisë,
- përgjegjësi politike, respektivisht kërkesë për dorëheqjen e mbajtësit të funksionit ekzekutiv ose propozim për shkarkimin e tij dhe/ose
- ngritjen e iniciativës për informimin e institucioneve kompetente, jo më vonë se një muaj nga dita e marrjes dijeni për mosrespektimin e këtij kodi, ligjit, veçanërisht Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Ligjit për Lobim.

Rekomandim sipas nenit 23: të veprohet në përputhje me masat e parashikuara me qëllim mbrojtjen e integritetit të funksionit publik dhe të Qeverisë si institucion.

II.5 Rasti - Prokurorja publike Lençe Ristoska



Fokusi i kësaj analize është [vendimi](#) i prokurores publike Lençe Ristoska për të dhënë [dorëheqje](#) nga funksioni i prokurores publike. Analiza bazohet në informacione të disponueshme publikisht, raporte mediatike dhe [reagime](#) në publik lidhur me rrethanat që çuan në këtë vendim.

Dorëheqja vjen pas një sërë vendimesh institucionale: [përfashtimi i Ristoskës nga lëndët “Talir 1” dhe “Talir 2”](#) nga prokurori publik i shtetit, si dhe [refuzimi i iniciativës së saj para Këshillit të Prokurorëve Publikë](#), në të cilën ajo kishte theksuar [presione dhe cenim të pavarësisë së saj](#).

Për më tepër, ajo së fundmi ishte candidate për prokurore publike të shtetit, por nuk u zgjodh nga Qeveria. Në këtë kontekst, Ristoska shpjegon publikisht se nuk mund ta vazhdojë funksionin në përputhje me parimet e saj. [Ristoska](#) është ish-anëtare e [Prokurorisë Speciale Publike](#), ku ka punuar në disa lëndë me profil të lartë, ndër të cilat “Talir 1”, “Talir 2” dhe “Target-Fortesa”. Pas shuarjes së PSP-së, ajo e vazhdoi karrierën në prokurorinë e rregullt, ndërsa paralelisht është e angazhuar edhe si

prokurore publike për lidhje me [Eurojust-in](#).

Rasti hap pyetje për kushtet e punës në prokurori, shkallën e pavarësisë së prokurorëve dhe raportin mes integritetit personal dhe kontekstit institucional, duke ndikuar gjithashtu në perceptimin për integritetin e institucionit dhe besimin e qytetarëve.

Vlerësimi i integritetit politik

Kategoria: Sundimi i ligjit

Vlerësimi: “Ndërtuese e normave” (+9)

Argumenti kryesor në këtë rast është përputhshmëria mes qëndrimeve të shprehura publikisht dhe vendimit të marrë. Ristoska tregon për kufizime në autonominë e saj profesionale, [presione politike](#) dhe pamundësi për të vepruar sipas parimeve të saj, pas së cilës pason një hap konkret: tërheqja nga funksioni. Një konsistencë e tillë përfaqëson një tregues të qartë të integritetit personal dhe profesional.

Edhe pse ekzistojnë interpretime të kundërta politike (përfshirë vlerësime se ky veprim është i [motivuar politikisht](#)), ato nuk e ndryshojnë thelbësisht faktin se bëhet fjalë për një akt personal të tërheqjes nga funksioni në kushte mosmarrëveshjeje me mënyrën e funksionimit të sistemit.

Sipas metodologjisë së Indeksit, ky lloj veprimi, tërheqje nga funksioni në kushte mosmarrëveshjeje me praktikatat institucionale, vlerësohet si “**Ndërtuese e normave**”, sepse vendos një standard për sjellje të përgjegjshme në funksion publik.

Argumentet kryesore

- Prokurorja publike Lençe Ristoska jep dorëheqje duke e arsyetuar publikisht si rezultat i pamundësisë për të vepruar sipas standardeve profesionale.
- Reagime publike nga [ekspertë të fushës](#) e interpretojnë dorëheqjen si [akt integriteti dhe sinjal për probleme në sistem](#), përfshirë vlerësime se ajo përfaqëson një tregues indirekt të gjendjes në prokurori.
- Pas publikimit të dorëheqjes, vijnë reagime nga publiku, ekspertët dhe subjektet politike. Një pjesë e analizave e vlerësojnë si akt integriteti dhe tregues të problemeve sistematike në prokurori, ndërsa [VMRO-DPMNE](#) në pushtet e cilëson si të motivuar politikisht.
- Prokurori i shtetit Saveski, në reagimin e tij, shpreh [keqardhje për dorëheqjen](#), duke theksuar se vendimet e tij ndaj saj nuk janë të motivuara politikisht, por janë [të pavarura](#).

Rasti si shembull i integritetit

Rasti i Lençe Ristoskës përfaqëson një shembull të tërheqjes publike nga funksioni me arsyetim të bazuar në parime personale dhe profesionale.

Vendimi për dorëheqje përbën një akt konsistent në raport me qëndrimet e shprehura publikisht. Brenda kornizës së Indeksit të Integritetit Politik, rasti klasifikohet si “Ndërtuese e normave” – pra një

situatë ku ekziston përputhje mes parimeve dhe veprimeve, pavarësisht kontekstit kompleks institucional dhe politik.

II.6 Rasti – Largimi nga grupi parlamentar dhe veprimi si deputet i pavarur i Mile Cekovit



Në fokus të kësaj analize është vendimi i deputetit Mile Cekov për ta lënë grupin parlamentar të partisë ZNAM, duke vazhduar të veprojë si deputet i pavarur. Sipas [deklaratave të tij në media](#), vendimi buron nga mospajtimet me politikat dhe rezultatet e pushtetit, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit, si edhe nga vlerësimi se partia ZNAM është larguar nga premtimet parazgjedhore, si rritja e pagës minimale, mbështetja për fermerët dhe masa të tjera. [Ai gjithashtu thekson heshtjen institucionale rreth rasteve të ndjeshme dhe mungesën e një zgjidhjeje ligjore](#), gjë që, sipas tij, bie ndesh me narrativën mbi të cilën është fituar besimi i qytetarëve.

Vlerësimi i integritetit politik

Kategoria: Mbrojtja e interesit publik

Vlerësimi: Ndërtues normash (+9)

Sipas metodologjisë së Indeksit, rasti klasifikohet si “Ndërtues normash”, sepse tregon një demonstrim publik të autonomisë politike dhe një largim parimor nga linja partiake në favor të interesit publik.

Argumentet kryesore

1. **Demonstrim i autonomisë dhe pavarësisë politike.** Vendimi i deputetit për ta [lënë grupin parlamentar për shkak të mospajtimeve](#) tregon aftësi për të vepruar në mënyrë të pavarur, që është element thelbësor i integritetit politik.
2. **Pozicionim parimor ndaj interesit publik.** [Kritikat e tij publike](#), veçanërisht për [luftën kundër korrupsionit](#) dhe përmbushjen e premtimeve, tregojnë se ai e vendos [interestin publik](#) përpara disiplinës partiake.
3. **Transparencë në komunikimin me publikun.** Vendimi dhe arsyet e tij janë bërë [publike dhe janë shpjeguar hapur](#), gjë që kontribuon në transparencë dhe llogaridhënie para qytetarëve. Edhe pse partia ZNAM [reagoi publikisht](#) duke theksuar se ekziston një mospërputhje parimore mes partisë dhe deputetit, nuk ka indikacione se Cekov është përjashtuar për shkak të këtyre dallimeve. Kjo e vendos atë në një pozitë moralisht më të fortë.
4. **Roli i deputetit si korrigjues i pushtetit.** Me kalimin në statusin e deputetit të pavarur dhe me [kritikën publike ndaj pushtetit](#), ai e forcon rolin e [Kuvendit si mekanizëm kontrolli](#).
5. **Kontribut në kulturën demokratike politike.** Veprime të tilla vendosin standarde sjelljeje [ku integriteti personal dhe profesional kanë përparësi ndaj besnikërisë partiake](#), çka është thelbësore për zhvillimin e një demokracie më të pjekur.

Përfundim

Rasti paraqet një shembull pozitiv të sjelljes politike që kontribuon në forcimin e standardeve demokratike dhe të integritetit institucional. Vendimi për të lënë grupin parlamentar dhe shumicën parlamentare, mbi bazën e mospajtimeve të argumentuara dhe të shpallura publikisht, thekson rëndësinë e integritetit individual në politikë.

Në kuadër të Indeksit të Integritetit Politik, rasti pozicionohet si “Ndërtues normash”, pra si shembull që kontribuon në zhvillimin e një kulture etike politike, llogaridhënieje dhe një roli më të fortë të institucioneve.

Rekomandime

- Partitë politike të zhvillojnë mekanizma funksionalë për debat të brendshëm dhe për raste mospajtimi.
- Të forcohen standardet etike që e vendosin përgjegjësinë publike përpara disiplinës partiake.

- Të nxitet komunikim transparent i vendimeve politike.
- Të përmirësohet roli i Kuvendit si organ i pavarur kontrolli.
- Të kultivohet një kulturë llogaridhënieje dhe vlerësimi kritik i pushtetit.

Rekomandime për deputetët e pavarur

- Të vazhdojnë t'i shpjegojnë qartë dhe publikisht vendimet e tyre, si bazë për besim te qytetarët.
- Të mbajnë fokusin te politikat dhe rezultatet konkrete, jo te konfliktet personale.
- Të ndërtojnë bashkëpunim rreth çështjeve dhe ligjeve konkrete, pavarësisht përkatësisë partiake.
- Ta përdorin pozitën e deputetit të pavarur për të forcuar rolin kontrollues të Kuvendit.
- Të krijojnë qëndrueshmëri në qëndrime përmes votimeve dhe iniciativave, jo vetëm përmes deklaratave.
- Të mbeten besnikë ndaj parimeve mbi të cilat e morën vendimin.
- Autonomia të bazohet në qëndrime të qarta politike dhe politika konkrete, jo vetëm në distancim nga partia.

III - Përfundim dhe rekomandime për forcimin e integritetit

Analiza tregon se besimi në institucione dëmtohet gradualisht, përmes situatave të përsëritura ku sjellja individuale nuk është në përputhje me standardet e pritshme dhe nuk ka sanksion të përshtatshëm, përfshirë edhe mekanizmat e parandalimit. Katër rastet negative tregojnë dobësi sistemike, por edhe mungesë të përgjegjësisë personale dhe respektimit elementar të standardeve etike. Në të njëjtën kohë, shembujt pozitivë tregojnë se integriteti nuk është çështje rrethanash, por zgjedhjeje. Integriteti nuk është i paarritshëm, por kërkon qëndrueshmëri dhe gatishmëri për të marrë përgjegjësi, veçanërisht kur kjo ka kosto personale dhe profesionale.

Mesazhi kryesor është se institucionet nuk e krijojnë besimin në mënyrë të pavarur; ato e ndërtojnë ose e humbin atë përmes sjelljes së individëve që i përfaqësojnë. Për këtë arsye, rikthimi i besimit në institucionet demokratike kërkon forcimin e integritetit në nivel individual, të mbështetur nga mekanizma të qartë dhe funksionalë institucionalë që e nxisin dhe e garantojnë këtë sjellje.

Erozioni i besimit nuk është vetëm rezultat i zgjedhjeve individuale, por edhe i mënyrës se si funksionojnë mekanizmat e brendshëm të institucioneve dhe përgjegjësia e drejtuesve të tyre. Po ashtu, rikthimi i besimit është i mundur, por vetëm nëse integriteti vendoset si standard i qëndrueshëm dhe jo si përjashtim, përmes zbatimit konsekuent të mekanizmave që sigurojnë ndërtimin dhe ruajtjen e tij.

Forcimi i besimit kërkon kombinim të masave individuale dhe institucionale. Nevojitet vendosja e mekanizmave të qartë për menaxhimin e konfliktit të interesit, që do të mundësojnë reagim në kohë dhe parandalim të dyshimeve. Institucionet duhet të kenë detyrim për reagim të shpejtë dhe transparent në raste të kontesteve publike, me qëllim që të zvogëlohet hapësira për spekulime.

Njëkohësisht, është e domosdoshme të zhvillohet kulturë e përgjegjësisë individuale dhe institucionale, ku dorëheqja nuk perceptohet si dobësi, por si shenjë integriteti. Përmirësimi i komunikimit me publikun dhe mediat duhet të bëhet prioritet, sepse ai ndikon drejtpërdrejt në perceptimin e llogaridhënies. Në fund, institucionet duhet të investojnë në mekanizma të brendshëm për monitorimin dhe forcimin e integritetit, me qëllim parandalimin e rasteve të ardhshme të sjelljes së komprometuar.

Përveç rekomandimeve të përgjithshme, që nënkuptojnë qasje thelbësore dhe reformuese në ndërtimin e sistemeve përmes të cilave do të forcohet integriteti, dhe që shpesh kërkojnë kohë dhe resurse, në ndërkohë janë të mundshme edhe rekomandime për dobësitë e identifikuara konkretisht përmes rasteve, të cilat mund të kenë zbatim të shpejtë dhe efektiv:

1. Mekanizëm detyrues për “përjashtim automatik” në rast konflikti potencial interesi

Në raste si ai me Dimovskën, ku ekziston lidhje familjare ose tjetër e afërt me çështjen, duhet të vendoset një procedurë e qartë që e kalon vendimmarrjen nga përgjegjësia individuale në një sistem të formalizuar, si p.sh.:

- funksionari është i detyruar brenda 48 orëve të raportojë konfliktin potencial të interesit;
- institucioni (p.sh. Këshilli Gjyqësor) është i detyruar brenda 5 ditëve të marrë vendim përfundimtar;
- mosveprimi aktivizon automatikisht procedurë disiplinore.

2. Periudhë për parandalimin e perceptimit të kooptimit

Duke u bazuar në rastin me Rallpovskin, nevojiten rregulla që vendosin distancë kohore dhe adresojnë drejtpërdrejt perceptimin e qytetarëve, me të cilat do të vendoset një periudhë minimale gjatë së cilës liderë sindikalë ose qytetarë nuk mund të emërohen në pozita ekzekutive ose drejtuese në institucione shtetërore të lidhura me fushën e tyre të veprimit, nëse në shoqëri në atë moment ekziston mungesë e dialogut strukturor ose ekziston protestë/demonstratë aktive për shkak të mosrespektimit të një të drejte sindikale.

3. Auditime të brendshme etike në sindikata dhe trupa të pavarur

Nga rasti i Tasevskit del nevoja për auditime etike vjetore të detyrueshme të organizatave sindikale dhe vendosje të trupave të brendshëm kontrollues me të drejtë pezullimi të përfaqësuesve në rast dyshimi për keqpërdorim.

4. Sistem evidencimi dhe transparence publike për angazhimin e funksionarëve

Në rastin e Fetait, problemi kryesor është padukshmëria e (mos)punës. Prandaj është e domosdoshme të vendoset një regjistër i centralizuar, publikisht i qashtë, për praninë dhe aktivitetet e bartësve të funksioneve publike (seanca, takime, udhëtime zyrtare), i shoqëruar me raporte për aktivitetin e tyre mujor.

5. Formalizimi i dorëheqjes si instrument integriteti

Bazuar në shembullin pozitiv me Ristoskën, është e nevojshme të vendoset një mekanizëm institucional ku funksionari ka detyrim të shpjegojë publikisht arsyet e dorëheqjes, ndërsa

institucioni ka detyrim të japë përgjigje zyrtare për pretendimet brenda 10 ditëve nga dorëzimi i dorëheqjes. Njëkohësisht, nevojitet mekanizëm me të cilin raste të tilla të trajtohen si indikatorë të dobësive sistemike, e jo si përjashtime individuale, dhe të ndikojnë në emërimet e ardhshme të funksionarëve.

6. Afate detyruese për reagim institucional

Për shkak të mungesës së shpeshtë të reagimit të institucioneve, është e nevojshme që në mekanizmat e brendshëm të vendoset rregull sipas të cilit çdo institucion duhet të reagojë (me qëndrim ose procedurë) brenda 7 ditëve nga shfaqja e një rasti publik me elemente integriteti, ndërsa mosveprimi të trajtohet si dështim institucional që duhet domosdoshmërisht të jetë objekt sanksioni.

Detyrimi institucional për publikimin e rezultateve të rasteve për të cilat ka raportim mediatik duhet të jetë rregull sistemik, sepse analiza tregon ndërprerje të vëmendjes pas lajmit fillestar për rastin, kështu që edhe kur ka rezultat pozitiv, si sanksion ose korrigjim të sjelljes, ai informacion mund të mos jetë i dukshëm për publikun dhe qytetarët.

7. Integriteti si kriter për avancim, jo vetëm për sanksion

Shembujt pozitivë (si Ristoska) është e nevojshme të përfshihen si kriter për emërimet e ardhshme, duke krijuar praktikë ku integriteti sjell “shpërblim” institucional, jo vetëm shmangie të sanksionit.

Këto rekomandime e zhvendosin kornizën nga deklarative në operative. Në vend që të mbështeten në vullnetin e mirë të individëve, ato vendosin rregulla të qarta, afate dhe pasoja. Në këtë mënyrë, integriteti pushon së qeni përjashtim që varet nga zgjedhja personale dhe bëhet sjellje e parashikueshme dhe e matshme, e mbështetur nga sistemi.

8. Publikimi i rezultateve të rasteve me interes publik

Institucionet duhet rregullisht dhe zyrtarisht të publikojnë rezultatet e rasteve që kanë shkaktuar interes të konsiderueshëm publik. Pa informacion për rezultatin përfundimtar, publiku mbetet me përshtypjen e pandëshkueshmërisë ose të paqartësisë, gjë që e minon më tej besimin në institucione.

9. Për mediat: ndjekja e rezultateve, jo vetëm e skandaleve

Mediat kanë rol kyç në zbulimin e rasteve që lidhen me integritetin, por po aq e rëndësishme është edhe ndjekja e zhvillimeve të tyre. Raportimi i vazhdueshëm për procedurat institucionale, sanksionet, vendimet shfajësuese ose korrigjimet e sjelljes kontribuon në informim më të plotë të publikut dhe parandalon sjelljen e përfundimeve të bazuara në informacione të paplota.